



In medias res

Koncepti i reformës kurrikulare

Inicimi centralist dhe i centralizuar i ndryshimeve kurrikulare nga qeveritë qendrore, pa konsultimin e mësimitdhënësve, pa hulumtimin e nevojave dhe të mundësive "... garanton një kurrikul të planifikuar, por jo edhe domosdoshmërisht të zbatuar"

Një psikolog italian me emrin Bendet Kroçe kishte zakon të thoshte "...para se të fillosh të bisedosh me mua, qartëso konceptet, sepse po nuk e bëmë këtë ka mundësi të mëdha të mos kuptohemi"

Në qartësimin e koncepteve insiston edhe pedagogjia konstruktiviste. Përfaqësuesi më tipik i saj; Hauard Gardner flet për të kuptuarit e plotë dhe jo të plotë të mësimit. Mësimi plotësisht i kuptuar është ai mësim kur nxënësit - studentët i kanë plotësisht të qarta konceptet dhe kur mësimitin e mësuar janë në gjendje ta zbatojnë në rrethana dhe kushte të reja. Nëse i kemi të qarta konceptet dhe nëse jemi në gjendje që diçka që e kemi mësuar ta zbatojmë në rrethana dhe kushte të reja, atëherë kemi të bëjmë me "mendjen e shkolluar" të bazuar jo vetëm në pedagogjinë konstruktiviste, por edhe në pedagogjinë maksimaliste, pedagogjinë e arritjeve më të larta të mundshme, që duhet të jetë synim si i shoqërive ashtu edhe i individëve. Për fat të keq studimet tregojnë se në këtë fushe ka shumë probleme. Pjesa më e madhe, jo vetëm e nxënësve dhe e studentëve, por, edhe e "ekspertëve" nuk i kanë gjithnjë konceptet e qarta. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me "mendjen e shkolluar" por me "mendjen e pashkolluar". Lidhur me këtë është shumë e dobishme të lexohet studimi i H. Gardnerit, "Mendja e pashkolluar". Për fatin e keq të Kosovës, jo në pak raste, shumë projekte tepër të rëndësishme të Kosovës janë duke u udhëhequr nga "Mendja e pashkolluar".

Kjo është arsyeja kryesore pse po ndalem në këtë rast në konceptin e "Reformës kurrikulare". Ajo që duhet ta kuptojmë së pari është se jo rrallë reforma kurrikulare identifikohet me inovime dhe zhvillime që kanë të bëjnë me futjen e ndryshimeve në kurrikula, me të cilat ndryshime synohet përmirësimi i sistemit të arsimit. Ky është një nga qëllimet e reformës kurrikulare. Përpos këtij qëllimi reforma kurrikulare duhet ta ketë të përkufizuar qartë qëllimin moral të saj. Me qëllim moral nënkuptohet qartësimi dhe konkretizimi i plotë i përfitimeve që qytetarët e një vendi do t'i kenë nga ndryshimet, inovimet, plotësimet, saktësimet kurrikulare.

Për këtë arsye reforma kurrikulare, përkatësisht inovimet dhe zhvillimet kurrikulare kursesi nuk mund të bëhen pa një hulumtim, identifikim të nevojave së qytetarëve, të shoqërisë dhe të synimeve të saj zhvillimore. Reformat e nisura nga lart pa këto identifikime mund të jenë të dashamirëse, mund të jenë atraktive dhe interesante, por ato nuk janë dobiprurëse sepse bazohen metodën e KUTISË së Zezë.

Meqë reforma kurrikulare ka për synim të përmirëson dhe të avancojë sistemin e arsimit të një vendi, ajo prek interesat e shumë njerëzve, për të mos thënë interesat e të gjithë qytetarëve të atij vendi dhe jo vetëm të atyre por edhe të vendeve të tjera të rajonit dhe me gjerë. Për këtë arsye në të duhet të marrë pjesë një numër shumë i madh i individëve, institucioneve vendore, rajonale dhe ndërkombëtare (politikanë, ekspertë për kurrikula, hartues të librave, pedagogë, psikologë, metodologë, hulumtues, mësimitdhënës, nxënës, prindër dhe partnerët e ndryshëm social-agjencitë e vendeve të tjera, shoqëria civile, sindikatat, organizatat humanitare dhe organizatat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, etj.

Për këtë arsye reforma kurrikulare është një proces shumë kompleks dhe afatgjatë shoqëror – politik (Fullan, 1982) i cili nëse ngutet, udhëhiqet dhe koordinohet nga mendja e pashkolluar paraprakisht është i dështuar dhe në këtë rast bëhet shkaktar i krizave dhe i tragjedi të mëdha. Në numrin e ardhshëm do të merremi me etapat nëpër të cilat kalon REFORMA KURRIKULARE.

Shkroi: Halim Hyseni

Projekti i granteve për zhvillimin e shkollave

■ Gjatë muajve korrik dhe gusht janë implementuar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve në kuadër të projektit të granteve për zhvillimin e shkollave. Në fillim të muajit korrik janë angazhuar tetë bashkëpunëtor profesional të terrenit (BPT), të cilët do të ndihmojnë Drejtoritë Komunale të Arsimit në përzgjedhjen e 151 shkollave në mbarë Kosovën, të cilat do të përfitojnë grante nga projekti për zhvillimin institucional të arsimit. Po ashtu, BPT-të do të kujdesen që shkollat përfituese të përgatisin dokumentacionin e nevojshëm për fitimin e granteve në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Banka Botërore. Në Prishtinë, BPT është vendosur në lokalet e KEC, ndërsa BPT e Pejës, Gjakovës, Ferizajit dhe Gjilanit janë vendosur në Qendrat Didaktike të shkollave përkatëse. Në komunën e Mitrovicës, BPT është vendosur në një zyrë afër shkollës Nëna Teresë, ndërsa BPT në Prizren pritet që të sistemohet në lokalet e reja të DKA-së. Gjatë muajit korrik, BPT kanë mbledhur informacion rreth statistikave të shkollave, të cilat do të përdoren gjatë përzgjedhjes së shkollave përfituese.

■ Më 26-27 gusht 2010 është mbajtur trajnimi për trajnerë për programin Plani Zhvillimor i Shkollës. Pjesëmarrës në trajnim ishin BPT-të si dhe drejtorë e mësimmshënës, të cilët do të aktivizohen për mbajtjen e trajnimeve për shkollat përfituese. Në fund të muajit Gusht, BPT kanë vazhduar me mbledhjen dhe korigjimin e statistikave të shkollave.

KOSOVISION Contest

■ Projekti KOSOVISION CONTEST ka përfunduar me një sukses të madh. Gjatë muajve korrik-gusht, në kuadër të këtij projekti është punuar në përgatitjet për realizimin e vitit të tretë të projektit KOSOVISION CONTEST. Përfaqësuesit nga Zvicra kanë nënshkruar kontratat e reja me kompanitë ndihmëse në projekt:

1. RTK për emetimin e programeve gjatë tërë vitit për arritjet e projektit,
2. Kompania "Tronit" për realizimin e materialit, incizimin dhe përgatitjen e punës,
3. Ambasadorët e projektit dhe
4. Stafin lokal që ndihmojnë në realizimin e projektit.

Projekti zyrtarisht fillon më 1 shtator 2010 dhe përfundon më 31 maj 2011.

■ Në fund të gushtit është mbajtur një punëtori me stafin lokal të këtij projekti. Qëllimi i punëtorisë ishte që stafi të njihet me materialet e punës dhe ndërrimet eventuale të bëra në këto materiale.

Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të projektit "Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit", financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, janë organizuar disa aktivitete. Gjatë muajit korrik dhe gusht janë bërë vlerësimet e projekteve të cilat janë realizuar në shkolla. Gjithsej kanë qenë 29 projekte të vogla që janë realizuar në shkollat e synuara të projektit. Po ashtu, gjatë këtyre muajve është punuar edhe në hartimin e raportit të parë për gjendjen e të drejtave të fëmijës në shkollat e synuara i cili raport pritet të dalë në diskutim gjatë muajit shtator të këtij viti. Raporti është dërguar në përkthim për gjuhë angleze dhe serbe.

Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

■ Më 04 korrik në Prishtinë u mbajt punëtorja rajonale për rishikimin e sintezës së raporteve kombëtare. Në këtë punëtori morën pjesë përfaqësues nga të gjitha shtetet partnere në projekt si dhe Gordana Miljevic nga OSI. Punëtorinë e udhëhoqi ekipi i ekspertëve i përbërë nga Anca Nedelcu, Eugen Palade dhe David Frost. Punëtorja doli shumë frytdhënëse si në aspekt të sintezës, po ashtu edhe në aspekt të projektit në përgjithësi. Sinteza u diskutua në detaje dhe u dhanë rekomandimet. Pas diskutimit të sintezës grupi vazhdoi me diskutimin e projektit dhe komponentëve të tij. U sqaruan aktivitetet e ardhshme dhe u caktuan afatet për to.

■ Gjatë gushtit është punuar në finalizimin e praktikave të mira dhe përgatitjen e tyre për tu botuar në formë libri.

Qasja Tërësektoriale në Arsim – EU EDUCATION SWAp

■ Projekti Qasja Tërësektoriale në Arsim - EU EDUCATION SWAp ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit të kaluar. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë (ECLO).

Projekti implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Cambridge Education, Qendra për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm.

■ Gjatë kësaj periudhe është organizuar një fokus grup lidhur me Kornizën e Kurrikulit të Kosovës. Qëllimi i këtij fokus grupi ka qenë që

përfaqësuesit e grupeve të pafavorizuara të përfshihen në procesin e diskutimit të KKK-së.

■ Gjithashtu, në kuadër të këtij projekti, në bashkëpunim të ngushtë me MASHT, është organizuar një punëtori treditore me koordinatore të grupeve punuese të cilët do të jenë bartës të zhvillimit të Kurrikulit të ri të Kosovës.



Në këtë punëtori u diskutuan shumë aspekte të Kornizës së Kurrikulit të Kosovës si dhe rolin që do të ketë kjo Kornizë në hartimin e kurrikulit të ri. Trajnerë në këtë punëtori ishin: Z. Richard Webber, ekspert ndërkombëtar i SWAp, si dhe Znj. Luljeta Demjaha dhe Znj. Eda Vula në cilësinë e ekspertëve vendor.

Koncepti i qytetarisë të nxënësit e shkollës fillore në Kosovë

■ Gjatë muajit korrik, ekipi nga KEC dhe UP, është finalizuar raporti hulumtimit të shpejtë si dhe është publikuar në Letrën Informative të KEC. Në bashkëpunim me partneret janë duke u shqyrtuar mundësitë e zhvillimit të këtij projekti (hulumtimi) në nivel të Kosovës.

Përgatiti: Petrit Tahiri